

Njoftim për përqendrim me të cilin Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft nga Gjermania do të fitoj kontroll të pavarur mbi RejsDipartment B.V. nga Holanda

(Lënda nr. 08-123 të vitit 2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 20.09. 2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, i cili i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft me seli të regjistruar në Porsheplac 1, 70435 Shtuttgart, Gjermani mbi RejsDipartment B.V. me seli të regjistruar në Lange Grafte 9, 7321 Apeldoorn, Holandë.

Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft është një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Gjermanisë. Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft është një prodhues prodhues gjerman, i specializuar në dizajn, prodhim dhe shpërndarje të makinave sportive me performancë të lartë, SUV. Selia e Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft ndodhet në Shtuttgart, Gjermani. Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft është një shoqëri e varur indirekte e kontrolluar në pronësi të plotë të Folksvagen Akciengezellshaft. Folksvagen është një shoqëri aksionet e të cilit tregtohen në mënyrë publike, me seli në Wolfsburg, (Gjermani), e cila është shoqëri udhëheqëse (mëmë) e Grupit Folksvagen.

Grupi Folksvagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura si më poshtë:

- Porshe Lizing SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me aktivitet bazë të regjistruar – lizing financiar;

-Porshe Broker SHA Skopje, me seli të regjistruar në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Skopje dhe me aktivitet bazë të regjistruar- veprimtaritë e përfaqësuesve të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit;

- Skania Makedonia SHPKNJP Ilinden, me seli në rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup dhe me aktivitet bazë të regjistruar- tregti me mjete të tjera motorike dhe

- Porshe Makedonia SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me aktivitet bazë të regjistruar- tregti të makinave dhe mjeteve motorike të kategorisë së lehtë.

Veprimtaria parësore e shoqërive të përmendura në Maqedoninë e Veriut është tregtia me automjete motorike dhe lizingut financiar.

RejsDipartment B.V. është përgjithësisht aktive me shitje të hapësirave online për reklamim dhe marketing në internet, shërbime për publicitet dhe përdorim, me fokus në lajmet (me pagesë) dhe përmbajtjen mediatike në lidhje me sportet motorike virtuale dhe reale, lojërave të garave, simulime të garave dhe harduerin dhe softuerin të lidhur.

RejsDipartment B.V. nuk është aktive dhe nuk realizon asnjë të ardhur në Maqedoninë e Veriut.

Tregu relevant i mallrave për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si (a) *sigurim i shërbimeve për reklamim online dhe (b) sigurimi i shërbimeve për përmbajtje të paguar dhe reklamuese në internet.*

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

22.09.2022

Shkup